

Enver DUGOLLI

MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS DHE BURGJET TJERA NË KOSOVË

Në këtë artikull do të trajtohen disa zhvillime që çuan në përkeqësimin edhe më shumë të situatës në Kosovës pas ngjarjeve të vitit 1981, para dhe pas suprimimit të autonomisë së Kosovës të vitit 1989; të dramës që e përjetoi populli shqiptar i Kosovës me theks të veçantë rinia, e cila u vu në funksion të rezistencës dhe luftës çlirimtare për liri dhe pavarësi. Arrestimet, burgosjet, torturat deri në masakra siç ishte ajo e burgut të Dubravës ku humbën jetën shumë të burgosur shqiptarë dhe shumë të tjerë u plagosen dhe u torturuan deri në vdekje, ishin bërë rutinë e zakonshme për organet shtetërore serbe, gjatë periudhës së viteve të nëntëdhjeta e deri në vitin 1999. Shumë të burgosur shqiptarë u vranë dhe shumë të tjerë u morën si pengje lufte dhe u dërguan në Serbi nga autoritetet shtetërore serbe. Fati i shumë të burgosurve shqiptarë të rrëmbyer nga forcat serbe nuk dihet ende as sot e kësaj dite.

Pas Demonstratave të mëdha të pranverës së vitit 1981, edhe pse pushteti i asaj kohe u mundua ta shtypte vullnetin e popullit për liri dhe barazi, nuk ia arriti. Në shenjë revanshi për atë çka ndodhi, autoritetet shtetërore jugosllave filluan masat e dhunës dhe persekutimit. Qindra mijëra shqiptarë u burgosen dhe u dënuan, por qetësia e pretenduar nuk dukej gjëkund. Shpërbërja e Jugosllavisë nuk po sillte ndonjë stabilitet, përkundrazi luftërat në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, po vërtetonin tezen e shqiptarëve, se: Jugosllavia ishte shndërruar në një shtet, jo të barabartë (jo vetëm për shqiptarët) dhe se hegjemonia serbe dominonte gjithandej. Elitat politike e Krahinës Autonome të Kosovës, me vonesë diktuan kahen e zhvillimeve, duke qëndruar jo në sinkron me kërkesat e popullit. Atëherë, kur e kuptuan ishte vonë, sepse Serbia shumë shpejt i zhveshi nga pushteti duke pamundësuar ndonjë vendimmarrje institucionale, ashtu siç vepruan republikat tjera. Në këtë situatë, populli prapë tentoi t'i rehabilitonte dhe të rreshtojë në mbrojtje të tyre, por, as kjo nuk bënte punë. Kreu i Serbisë, Millosheviq me lehtësi po avanconte drejt qëllimeve të tija. Përkundër grevave dhe demonstratave të fuqishme, si asnjëherë me parë, shqiptarët u nxorën nga puna, nga shkollat dhe nga e gjithë jeta

publike. Shqiptarët provuan të vetorganizoheshin duke e venë në sprovë veten e tyre, por edhe armikun. Lindja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) u prit me euforizëm të madh, duke shënuar kapërcimin më të madh historik të unifikimit. Shumë shpejt LDK-ja u shndërrua në lidhjen e vetme, e cila i bashkonte shqiptarët me besim dhe vullnet drejt sendërtimit të interesave të tyre për liri e barazi. Besimi në LDK-në dhe udhëheqësin e saj (Ibrahim Rugova), ishte aq i madh, sa me verbëri i bindeshin edhe për ndaljen e protestave dhe demonstratave që bëheshin. Ishte shumë i çuditshëm fakti se, ndaljen e demonstratave dhe grevave nuk kishin mundur ta ndalnin as tanket e Serbisë, e tani po e bënte LDK-ja dhe kryetari Rugova, edhe atë krejt në mënyrë paqësore! Natyrisht, shqiptarët i kishin hesapet e tyre dhe llogarisnin në një formë tjetër të arrinin qëllimin, mirëpo në njëfarë mënyre edhe Serbisë i konvenonte kjo qetësi e shqiptareve, derisa po merrej me luftërat në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Atë “qetësi” të krijuar, Serbia mendohej ta shfrytëzonte edhe në arenën ndërkombëtare, duke u arsyetuar se në Kosovë nuk kishte probleme, sepse mbretëronte paqja, pra, nuk kishte luftë. Edhe pse ishim të përjashtuar nga të gjitha institucionet publike e shtetërore, fakti se nuk kishte luftë të hapur sikur në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, Kosova ishte vendosur në listën e rajonit të paqes, paçka se kishte probleme. Duke e shfrytëzuar këtë situatë, Serbia avanconte në dy drejtime. Me që, organizimin paqësor të asaj kohe nuk e ndalte, ajo maksimizonte shtrirjen e ndikimit përmes aparatit të dhunës, duke mbjellë frikë e panik dhe duke e zbrazur Kosovën nga rinia.

Gjatë kësaj kohe, ndonëse nuk kishte të burgosur politikë, sikurse pak vite më herët, ndalimi dhe bisedat informative në polici ishin shpeshuar. Tani burgjet klasike ishin zëvendësuar me qendrat e mbajtjes nëpër të gjitha stacionet policore në gjithë vendin. Ankesat e partive politike (LDK) dhe raportet e organizatave humanitare që monitoronin situatën në terren, nuk u bënë përshlyetje. Madje, kur ndonjë organizatë ndërkombëtare e të drejtave të njeriut arrinte që në ndonjë forum të tregonte pikturën e vërtetë të aparteidit në Kosovë, kreu i Serbisë (Sllobodan Millosheviq) kundërshtonte ato raporte, me arsyetimin se atje gjithçka ishte në rregull, sepse nuk kishte luftë. E vërteta ishte se lufta mungonte, por, Kosova ishte në gjendje të mjerueshme! Duke qenë se dhuna po shtoej, sidomos në pjesët rurale të vendit, alternativa paqësore, LDK-ja e proklamuar si e vetmja zgjidhje, filloi të shihej me skepticizëm nga një pjesë e vogël e njerëzve dhe nga rinia studentore. Madje, kishte grupe të organizuara ushtarake që metodat paqësore pasive i shihnin pa efekt qysh në fillim të zbatimit të tyre. Kështu që, filloi organizimi dhe zgjerimi i tyre çdo ditë e më shumë. Prijatar i këtij koncepti ishte grupi i Adem Jasharit në Drenicë, të cilët kishin lidhje dhe bashkëpunim edhe me grupet tjera, si: në Llap,

Dukagjin etj. Kjo ishte bërthama e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila me këtë emër u paraqit, pak më vonë. Me një koncept dhe metoda më ndryshe, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, po bëhej gjithnjë e më shumë faktor determinues i lirisë së Kosovës. Ndonëse, në fillim tentohej të minimizohej roli i tyre, deri në masën e mohimit real të ekzistencës, simpatia e njerëzve për këtë formacion rritej gjithnjë e më shumë. Kjo simpati dhe përkrahje lidhej edhe me faktin se dhuna, përcmimi dhe terrori i Serbisë ndaj shqiptarëve ishte rritur në atë masë, sa nuk durohej më.

Burgosja e grupeve të organizuara (UÇK dhe LKÇK) nga fundi i vitit 1996 dhe fillimi i vitit 1997, që në program kishin luftën e armatosur, si metodë për çlirim, kishin bërë bujë të madhe në përqafimin e idesë dhe konceptit ndryshe nga ai pacifist. Organizimi i rinisë studentore, sidomos të Unionit të Pavarur Studentor të Universitetit të Prishtinës, i cili kishte filluar të organizohej me një Platformë të rezistencës paqësore aktive, e sidomos me rastin e organizimit të protestës së 1 tetorit 1997, po vuloste një etapë tjetër politike për Kosovën. Thirrjet e politikës paqësore të kohës për vetëpërbajtje dhe qetësi, përfundimisht dështuan në vitin 1998, pas aksioneve ushtarake të UÇK-së dhe ekspeditave ndëshkuese të Serbisë, në Drenicë. Shqiptarët, më në fund, e kishin mundur frikën.

Koncepti socio-historik për burgun

Burgu si një koncept socio-historik, ka lindur si nevojë e mbajtjes dhe mirëmbajtjes së disa normave të kodifikuara në funksion të ruajtjes së parimeve ndëshkuese ndaj keqbërësve të kualifikuar. Debatet rreth konceptit burg, e sidomos ndëshkimit si metodë, vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Sipas filozofit postmodern Michael Foucault, ekzistenca dhe mbarëvajtja e këtij institucioni i nënshtrohen interesit madhor të pushtetit në një ekonomi politike të menaxhimit të sjelljes së individëve dhe trupit të tyre. Kjo arsye e fundit, ka lindur historikisht teknikat e mbikëqyrjes dhe disiplinimit deri tek teknika e sofistikuar e ashtuquajtur “*panoptikonit*” ku i burgosuri nuk mund të shoh nëse roja është në kullë, apo jo, e si pasojë, ai duhet të silllet sikur mbikëqyrja të ishte e vazhdueshme, e pandërprerë dhe tërësore, duke bërë të burgosurin roje të vetes. Ndërsa, burgu si instrument, u përdor në përmasa shqetësuese në shtetet diktatoriale dhe në ato komuniste, për disiplinimin e kundërshtarëve politikë, krim ky, i cili konsiderohej dhe gjykohej më shumë dhe më ashpër se cilido krim ordiner; si vrasjet dhe krimet tjera. Në kuadër të kësaj, regjimet komuniste ndërtonin një mekanizëm të rafinuar shtetëror dhune dhe terrori. Dhuna konsiderohej mjeti i vetëm për marrjen e pushtetit, ndërsa, terrori ishte i domosdoshëm për ta konsoliduar dhe përjetësuar

pushtetin dhe kultin e individit të lidërsipit komunist.¹ Kjo moto represaliesh ndaj kundërshtarëve politikë, dhe të cilët shpallëshin me automatizëm edhe armiq të popullit dhe shtetit, zbatohëshin pa dallime në të gjitha shtetet komuniste. Në emër të kësaj, arsyetohëshin krimet e rënda, të shkaktuara ndaj popujve tragjikë, që fati historik i kishte renditur brenda këtyre ngrehinave komuniste, që dominonin në një pjesë të madhe të Evropës. Dimënsioni i krimeve komuniste ishte gjithandëj prezent, mirëpo vendet ku krahas padrejtësive shoqërore përballëshin edhe me padrejtësitë etnike, ishin shembuj tipikë i dhunës sistematike mbi baza etnike, e që kamuflohëshin me terma të ndryshme politike të ruajtjes së “fryteve” të socializmit dhe barazisë.

Kosova e cila padrejtësisht u ripushtua pas Luftës së Dytë Botërore, ishte në pozitën më të vështirë të mundshme, që nga pushtimi osman. Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe çlirimit nga nazifashizmi, fillimisht në Drenicë e pastaj në gjithë vendin, aplikohet gjendja e jashtëzakonshme, me masat e shtetrrëthimit ushtarak, dhe kryhen krimet të tmerrshme gjithandëj vendit. Pushkatimet me gjyq e pa gjyq, internimet dhe burgosjet, linçimet dhe zhdukjet pa gjurmë, ishin format dhe metodat që zbatohëshin ndaj shqiptarëve të Kosovës, dhe viseve tjera të banuara me shqiptarë, nën Jugosllavi. Madje burgjet ishin mbipopulluar me “armiq të popullit e shtetit” sa që detyrohëshin t’i depërtonin edhe në republikat tjera të Jugosllavisë, deri në Slloveni. Nëse burgjet ishin vendi i privimit nga liria dhe ndëshkimi për vepra kriminale, për shqiptarët nën Jugosllavi, burgu ishte vetëm një vend izolimi i përmasave më të vogla, nga se, ashtu siç thoshte Mandela i Evropës, z. Adem Demaçi, “*Kosova dhe viset tjera shqiptare ishin shndërruar në burgun më të madh në Evropë*”. Vetëm në periudhën kohore të vitit 1945-1990 (hiq dekadën e fundit deri 1999, dhe luftën) shqiptarët nën ish-Jugosllavi, u dënuan në procese gjyqësore me 666 shekuj e 72 vjet e 6 muaj!² Në vitin 1986, Kosova e kishte numrin më të madh të të burgosurve politikë në gjithë Evropën, përfshirë këtu edhe Bashkimin Sovjetik. Në burgjet jugosllave më shumë se 80% e të burgosurve politikë ishin shqiptarë, ndërsa në strukturën e përgjithshme të

¹ Beqir Meta, Ermal Frashëri, *Raport i Autoritetit për informim mbi dokumentet e ish-sigurimit të shtetit* (Tiranë:

2018), https://www.undp.org/content/dam/albania/img/Publications/Studimi_Kornize%20or%20web.pdf

² Sabile Keçmezi-Basha, *Të burgosurit Politikë Shqiptarë në Kosovë, 1945-1990*, (Prishtinë: LOGO-S, 2009), i gjithë libri.

popullsisë merrnin pjesë me 6-7%.³ Këto të dhëna i konfirmojnë edhe raportet e ndryshme të shoqatave si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) me seli në Prishtinë, në raportet e publikuara në vazhdimësi shpaloste këto shifra për opinionin.

Përveçse me burgje, biseda informative dhe izolime, shqiptarët përjetuan edhe aparteidin e viteve të '90-ta. U mbyllën shkollat, fakultetet dhe u përjashtuan nga puna mijëra punëtorë vetëm e vetëm se ishin shqiptarë. Por, nuk ishin vetëm këto forma të ndëshkimit dhe përndjekjes. Pushteti “popullor” i Jugosllavisë, aplikonte metoda të ndryshme të ndjekjes dhe represionit për shqiptarët. Kështu që, në vazhden e projektit të spastrimit të heshtur etnik, më 28 shkurt 1953, nënshkruhet një marrëveshje në mes tri shteteve: Jugosllavisë-Turqisë dhe Greqisë e cila e validonte Konventën Jugosllave-Turke, të vitit 1938, për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Për të shtuar masat represive, aksioni i mbledhjes së armëve⁴ i organizuar nga pushteti “popullor” nisej nga parimi i vendosur se kujt t'i kërkohet arma, duhet ta dorëzojë ose armën ose shpirtin. Shqiptarët e përballuan edhe këtë, por nuk u dorëzuan. Kosova dhe viset tjera të banuara me shqiptarë, ishin shndërruar në burgun më të madh kolektiv, prandaj gjendja ishte bërë e padurueshme.

Burgjet sekrete serbe në Kosovë

Pas vitit 1989, kur zyrtarisht Serbia ia suprimoi autonominë Kosovës, sikur çdo institucion publik e shtetëror edhe burgjet në Kosovë u vunë nën administrim direkt të Serbisë. Drejtuesit shqiptarë të burgjeve, ata politikë dhe institucionalë, të cilët nuk u pajtuan me veprimet e Serbisë, natyrisht se u përzunë nga pozitat e tyre drejtuese duke u zëvendësuar, kryesisht me zyrtarë serbë. Madje, duke u ndjerë të kërcënuar dhe të pafuqishëm në kryerjen e detyrave, një numër i madh i gardianëve shqiptarë ose u larguan ose i lëshuan vendet e tyre të punës në shenjë kundërshtie ndaj masave të dhunshme të Serbisë. Tani edhe burgjet i ngjasonin tërësisë së qenies sonë kombëtare, kur shumica absolute shqiptare sundohej nga një pakicë serbe. Që nga drejtori e deri te hallka e fundit komanduese ishin serbë. Madje edhe gardianët në shumicë ishin serbë, me ndonjë përjashtim,

³ Jakup Krasniqi, Vështrime *Pranvera Shqiptare '81, një drejtim i ri në politikën shqiptare*, (Prishtinë: Koha, 2017), <https://www.koha.net/veshtrime/5017/pranvera-shqiptare-81-nje-drejtim-i-ri-ne-politiken-shqiptare/>

⁴ Aksioni famëkeq i mbledhjes së armeve i vitit 1955/56, nga Ministri i Punëve të Brendshme, Aleksandër Rankoviç.

ku gjendej ndonjë shqiptar dhe aty këtu ndonjë minoritar, joserb. Hallkat e dhunës sistematike serbe ndaj shqiptarëve zbatoheshin me zell të madh kudo nëpër burgje.

Me që arrestimet dhe burgosjet e vitit 1996-1997 kishin target grupet të quajtura “terroriste” shqiptare, vëmendja e autoriteteve serbe në trajtimin e tyre ishte më e fokusuar se zakonisht. Përveç fazës së parë të hetuesisë, pas arrestimit (e që ishte e tmerrshme me tortura të llojllojshme), “kujdesi” ndaj të burgosurve shqiptarë (sidomos të atyre politikë), ishte një program në vete. Çdo lloj humbjeje e forcave serbe nga aksionet e UÇK-së, në terren, përfundonte me shfryrje mllefi dhe torturimi ndaj të burgosurve, të cilët tani e tutje mbaheshin edhe si lloje pengjesh.

Pra, kishte pushuar së zbatuari parimi i të drejtave të garantuara ligjore ndaj të burgosurve si dhe i shumë konventave ndërkombëtare që garantonin trajtim me dinjitet ndaj të burgosurve. Në fakt, ky parim dhe kjo konventë gjithmonë ishte anashkaluar, kur bëhej fjalë për të burgosurit politikë shqiptarë, mirëpo tani kishte marr një trajtë të re. Mbytja e shumë shqiptarëve me torturë në burgje dhe në zyrat e UDB-së, ishte dëshmia më e mirë e kësaj trajte të re. Sipas evidencave dhe raporteve të KMDLNJ-së, mediave dhe organizatave tjera humanitare, vetëm gjatë vitit 1997-1998, tre të burgosurit: Besnik Restelica, Rexhep Bislimi dhe Cen Dugolli, vdiqën nga torturat në burgun e Prishtinës. Kur gjurmohen rastet e vdekjeve të shqiptarëve në burgje, përveç datave, emrave dhe vendeve, e përbashkëta e të gjitha këtyre vdekjeve janë raportet zyrtare të lëshuara, ku për secilin rast gjendet ndonjë sëmundje shoqëruese e të burgosurit që i ka shkaktuar vdekjen?! Kështu kishte ngjarë edhe në rastin e Fazli Greiçevcit, që ishte mbytur në torturë shumë kohë më parë (1964), Zija Shemsiut etj.

Gjatë viteve 1997-1999 (madje deri në 2002, në Serbi⁵), pasiguria në burgje ishte e pranishme gjithandej. Kishte mungesa elementare të ushqimit, pastërtisë e mos të flasim për kushte tjera. Në të gjitha burgjet ushtrohej dhunë sistematike; me vrasje, tortura, keqtrajtime, fryje, denigrime e deri tek dhunimet seksuale, të cilat kanë ndodhur ndaj një të burgosuri në burgun e Beogradit, pas përfundimit të luftës, më 1999. Është i trishtueshëm fakti se të burgosurit kriminelë serbë, të nxítuar nga zyrtarë të atij burgu, dhunojnë një të burgosur shqiptar, të plagosur në masakrën e Dubravës, të cilin gjoja e kishin dërguar në Burgun Qendror (CZ) për ta shëruar. Të burgosurit serbë

⁵ Pas marrëveshjes së Kumanovës më 9 qershor 1999 në mes NATO-s dhe Serbisë, ishin marr me vete në Serbi të gjithë të burgosurit shqiptarë të cilët u mbajtën si pengje lufte deri në vitin 2001. Duke mos qenë pjesë pala shqiptare në këtë marrëveshje, çështja e të burgosurve politikë dhe pengjeve të luftës kishte mbetur si mos më keq. Faktori ndërkombëtar nuk ishte treguar i kujdesshëm lidhur me këtë çështje.

për krime të rënda, janë shfrytëzuar nga autoritetet zyrtare serbe për të ushtruar dhunë e terror ndaj të burgosurve shqiptarë, deri në pushkatimet masive në burgun e Dubravës. Opinioni publik di shumë pak rreth burgjeve legale të aplikuara ndaj shqiptarëve, por, nuk di asgjë rreth burgjeve të fshehta, ku janë mbajtur, torturuar dhe zhdukur të burgosurit e kidnapuar.

Zakonisht këto lloje burgjesh sekrete janë shfrytëzuar nga shërbimi sekret i Serbisë (UDB apo DB), për t'i ikur vëmendjes së opinionit publik. Ky shërbim sekret i fshehtë dhe shumë kriminel, kidnaponin veprimtarë të ndryshëm dhe i mbanin në ato vende, duke ushtruar torturë të jashtëzakonshme pa dhënë asnjë llogari procedurale dhe ligjore. Janë të pakt ata shqiptarë, që kanë dalë të gjallë nga ato “vende”, por të cilët na e vërtetojnë tezen e ekzistencës së burgjeve sekrete. Janë Nait Hasani dhe Besim Rama, dy të burgosurit, që fillimisht pas arrestimit të tyre për një kohë janë mbajtur në burgje sekrete të UDB-së. Besim Rama ishte kidnapuar më 17 shtator 1996, dhe mbahet aty deri më 5 tetor 1996, ku e dërgojnë në burgun e Prishtinës. Besimi edhe sot e kësaj dite, nuk e di saktë vendin ku është mbajtur për aq kohë. Ndërsa, Nait Hasani, kidnapohet më 28 janar 1997, dhe mbahet (torturohet mizorisht) në këtë burg sekret, deri më 27 shkurt 1997, kur e dorëzojnë fillimisht në spital, e më pastaj në burgun e Prishtinës. Fatbardhësisht, nga përshkrimi i vendit dhe i hapësirës përreth, Nait Hasani, ka mundur të identifikoi se ai vend ishte në Hajvali. Mbajtja e tyre pa asnjë informacion apo procedurë ligjore ishte në kundërshtim edhe me ligjet e tyre, mirëpo kur bëhej fjalë për shqiptarët, ligjet nuk vlenin. Naiti dhe Besimi ishin me fat që shpëtuan të gjallë, por fati i tyre lidhej edhe me faktin se në vitin 1997, kur ata u kidnapuan, ende nuk kishte eskaluar situata e luftës së hapur.

Deri tani dihet edhe për dy kidnapime të tilla, për dy veprimtarë shqiptarë, Xhavit Hazirin dhe Hafir Elshanin, të cilët nuk u kthyen kurrë më, nga ato vende, ku u mbajtën. Pra, u kidnapuan (kishte dëshmitar që i panë kur u morën), u dërguan në drejtim të panjohur dhe u zhdukën më pastaj. Ende edhe sot e kësaj dite nuk ka asnjë shenjë për fatin e tyre. Asnjëherë nuk pati ndonjë raport zyrtar për arrestimin dhe fatin e tyre. Për më keq, asnjëherë nuk u ngrit çështja e burgjeve sekrete serbe të cilat kanë ekzistuar. Sipas dëshmitarëve të gjallë dhe të cilët fatbardhësisht kanë shpëtuar, dihet për qendrën sekrete të mbajtjes në Hajvali dhe Blinajë (Lipovicë), mirëpo ekzistojnë dyshime të bazuara se numri i tyre mund të jetë shumë më i madh.

Cili ishte skenari serb i masakrës në burgun e Dubravës

Për masakrën në burgun e Dubravës, po e filloj me dy pikat e aktakuzës në Tribunalin e Hagës, për krime lufte në ish-Jugosllavi, kundër krerëve më të lartë të shtetit të Serbisë. “... Më 22 maj 1999, ose rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, një roje burgu në uniformë në kompleksin e burgut të Dubravës (komuna e Istogut) kërkoi prej kullës së vrojtimit se të gjithë të burgosurit duhet t’i mblidhnin plaçkat e tyre personale dhe të radhiteshin në fushën e sportit, në kompleksin e burgut, për transferim në burgun e Nishit, në Serbi. Brenda një kohe shumë të shkurtër, qindra të burgosur u mblodhën në fushën e sportit me plaçkat e tyre në çanta, dhe u radhitën për të pritur transportimin. Pa paralajmërim, rojat e uniformuara të burgut hapën zjarr kundër të burgosurve, prej kullës së vrojtimit, prej vrimave në murin rrethues dhe prej foleve të zjarrit, jashtë murit. Shumë të burgosur u vranë menjëherë dhe qindra të tjerë u plagosën.

Më 23 maj, (ose rreth kësaj date), pasdite, rojat e burgut dhe policët specialë serbë, hodhën granata dhe qëlluan në kanalet e shkarkimit, kanalet e ujërave të zeza, në godina dhe bodrume, duke vrarë dhe plagosur shumë të burgosur të tjerë të cilët kishin kërkuar strehim në këto vende, pas ngjarjeve të ditës së mëparshme. Rreth 50 të burgosur gjithsej u vranë. (Shumë prej të burgosurve të vrarë mbetën të paidentifikuar. Mirëpo, emrat e personave të vrarë që dihen janë radhitur në Shtesën J, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)...”.⁶ Edhe pse çuditërisht askush nuk u dënua për këtë masakër të tmerrshme, e vërteta e Dubravës qëndron. Masakra e Dubravës është shembulli më tipik i çmendurisë fashiste serbe, në fund të shekullit njëzetë XX!

Burgu i Dubravës apo Qendra Ndëshkuese-Korrektuese në Istog, siç quhej zyrtarisht në vitet e tetëdhjeta, kur edhe u ngrit si një nga kompleks - burgjet më të mëdha dhe më moderne të rajonit, ndodhet në perëndim të Kosovës, në fshatin Dubravë të Istogut, dallohej nga burgjet e tjera në sistemin ndëshkimor të Jugosllavisë-Serbisë, vetëm për nga arkitektura moderne dhe pozicioni, pasi brenda mureve mbizotëronte po ajo mikroklimë e ajo torturë, po i njëjti korrupsion i “risocializimit”. Për shkak të lokacionit specifik, Dubrava ishte nën vëmendjen, paksa, më të madhe të syve të botës. Në vitin 1997, nga gjithsej 46 të burgosurit politikë të regjistruar në Kosovë, nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, një pjesë e konsiderueshme e tyre, tanimë gjendeshim në Dubravë. Në prill të vitit 1997, fillon zbrazja e këtij burgu

⁶ Tribunali penal ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë lënda nr. it-99-37-i prokurorja e tribunalit kundër Slobodan Millosheviqit, Millan Millutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit, Vllajko Stojilkoviqit, Dorëzuar nga Prokurorja e Tribunalit të Hagës për krimet e luftës në ish-Jugosllavi: 29 qershor 2001.

nga të burgosurit. Fillimisht i largojnë të burgosurit politikë shqiptarë e pak muaj më vonë i largojnë edhe të gjithë të burgosurit ordinerë. Ekzistojnë të dhëna se gjatë verës së vitit 1998 e deri me fillimin e bombardimeve, ky vend u shfrytëzua si bazë e fuqishme e njësisë speciale të policisë, e cila udhëhiqej nga krimineli i njohur serb Millorad Ulemek “Legija”. Sipas dëshmimeve të dëshmitarëve në procesin e filluar në Hagë, gjatë kohës, për të cilën po flasim, nga kjo bazë janë organizuar ekspedita ndëshkuese kundër fshatrave shqiptare përreth Istogut, dhe më gjerë. Fillimi i bombardimeve të NATO-s mbi caqet e ushtrisë dhe policisë serbe, kishte ndryshuar edhe taktikat e veprimit të këtyre të fundit. Të gjendur para këtij rreziku, ata filluan të ndryshojnë metodat e veprimit, por që në thelb kishin të njëjtin qëllim. Vrasjet, masakrat, dëbimet, dhunimet dhe plaçkitjet ishin qëllimi kryesor i shtetit serb. Tani më, kur po shihej në horizont edhe fundi i tyre (dihej që nuk do mundnin edhe gjatë t’i përballonin sulmeve të NATO-s), filluan të përdornin mjetin e tyre të njohur, dinakërinë e kamufluar.

Përdorimi i hapësirave të burgut të Dubravës nga ana e njësisë speciale të policisë dhe ushtrisë serbe, e kishte kthyer në cak legjitim të goditjes nga ana e NATO-s. Prandaj, duke e ditur këtë fakt, struktura të larta udhëheqëse të Serbisë, përgatiten planin e kamufluar duke i kthyer hapësirat e brendshme të kësaj baze në origjinë. Shumë shpejt dhe në mënyrë të organizuar stërbushën hapësirat e brendshme të burgut të Dubravës me të burgosur shqiptarë, të cilët i merrnin nga të gjitha burgjet e Kosovës, nga qytetet dhe fshatrat e ndryshme, madje i kthenin të burgosurit edhe nga burgjet e largëta të Serbisë. Sipas një hulumtimi të bërë nga Fondi për të Drejta Humanitare e Natasha Kandiçit dhe hulumtimit të gazetarit Milica Jovanović⁷, plani për masakrimin e të burgosurve shqiptarë ishte bërë në atë mënyrë që vrasjet t’i atribuoheshin sulmeve ajrore të NATO-s. Ky ishte plani A, por nuk kishte munguar edhe plani B. Planin A kishte ndodhur vetvetiu nga fakti se NATO ishte gjendur në kurthin e ngritur dhe pa dashje që të dëmtonte objektivat civile e aq më pak të burgosurit, kishte sulmuar objektet e burgut, më 19 dhe 21 maj 1999. Me që pasojat e goditjes së NATO-s nuk i kënaqën serbët, ata filluan të aktivizojnë planin B. Sipas këtij plani duheshin vra sa më shumë shqiptarë në mënyrë që këto vrasje t’ia vishnin NATO-s. Ky plan ishte mjaft perfid, ku synohej që me një gur t’i vrisnin edhe shqiptarët edhe NATO-n. Natyrisht, për këtë plan kishin punuar bukur shumë në mënyrë që të kamuflonin sa më shumë pasojat.

⁷ Milica Jovanović, *Krimi shtetëror në burgun e Dubravës*, (përkthyer nga: Murlaj Jasiq, 2014). <https://pescanik.net/krimi-shteteteror-ne-burgun-e-dubbrates/>

Çka kishte ndodhur në mes datës 19-24 maj 1999

Pasi u stërbushën hapësirat e burgut të Dubravës për një muaj rresht, tani nuk kishte dyshim se në atë “qetësi” morbide, ku natën vjedhurazi shkëputeshin dhe torturoheshin njerëzit barbarisht, pritej diçka më e hapur dhe më e tmerrshme. Dhe ai moment erdhi. “Befasia” po ndodhte në burg. Më 19 maj 1999, zhurma e avionëve të NATO-s prishi qetësinë e paradites. Fluturimet e tyre dëgjoheshin çdo ditë, mirëpo atë ditë goditjet ishin më afër burgut. Nuk vonoi dhe u dëgjua një goditje shumë e fuqishme nga avionët e NATO-s. Fillimisht u godit pavijoni C, i cili kishte një distancë nga pavijonet tjera, ku gjendeshim ne të burgosurit e tjerë.

Diçka e pakapshme dhe shumë absurde, por ishte fakt se gardianët që ndodheshin në pavijonet tjera, në zyrat e tyre, duke parë rrezikun e goditjeve, në vend që të hapnin dyert dhe të linin të burgosurit të paktën të dilnin në oborr, ata ikën me një shpejtësi të padiktueshme dhe e kaluan tërë perimetrin e brendshëm të burgut. I lanë të burgosurit të mbyllur dhe në mëshirën e fatit. Nuk vonoi shumë, dhe u godit pavijoni tjetër, shumë afër (neve) pavijonit B, ku ishte i stërbushur me të burgosur.

Ky pavijon gjendej në mes të pavijonit C dhe B. Të burgosurit brenda këtyre pavijoneve u alarmuan nga rreziku dhe filluan të provonin që t’i thyenin dyert e mbyllura, që të paktën të dilnin jashtë në oborr, mirëpo ishte e pamundur të bënin ndonjë mrekulli, ngase dyert ishin të hekurta dhe nevojiteshin mjete të forta për hapjen e tyre. Heronjtë e asaj dite ishin pikërisht të burgosurit ordinerë shqiptarë, të cilët, në momentin kur filloi goditja e avionëve të NATO-s, kishin qenë në oborr, kuzhinë apo gjetiu, duke kryer punët e zakonshme të përcaktuara nga drejtuesit e burgut. Kur e panë se edhe gardianët ia mbathën jashtë mureve dhe i lanë të burgosurit e mbyllur, morën guximin dhe iniciativën për t’u dalë në ndihmë të burgosurve të mbyllur. Me mjetet e punës që kishin me vete, shumë shpejt, i thyen dyert dhe drynat duke i nxjerrë të gjithë të burgosurit në oborr. Edhe pse jashtë pavijonit të burgosurit ishin ende në burg, mirëpo mundësia për të shpëtuar ishte më e madhe, sepse hapësira për të ikur dhe strehuar, aty vërdallë, në oborr ishte më e madhe. Shumë shpejt u mësua se goditja e pavijonit C, kishte qenë fatale për 3 të burgosurit: Enver Topalli, Gjokë Nderca dhe Abdullah Tahiri. Ishin plagosur lehtë ose rënd edhe 9 të tjerë. Posa pushuan bombardimet, u hap porta kryesore dhe u futën brenda gardianë e mbikëqyrës të armatosur dhe të përgatitur si për luftë. Me një ton, jo edhe shumë urdhërues, urdhëruan të burgosurit që të rreshtoheshin secili para pavijoneve të veta. Turma e gardianëve dhe mbikëqyrësve që ishin futur brenda, po shoqëroheshin edhe me të burgosur serbë. Njiheshin mirë nga të burgosurit. Ishin aty për vepra të rënda kriminale. Mirëpo, habia,

jonë, nuk kishte të bënte përse ishin në shoqëri të gardianëve, por ngase ishin të armatosur me armë automatike dhe revole, që i mbanin në gjendje gatishmërie. Dhe kjo ishte shenjë jo e mirë. Të burgosurit serbë ishin armatosur në mënyrë të organizuar shtetërore, për të kryer krime dhe masakra ndaj të burgosurve shqiptarë, dëshmon edhe një hulumtim i “Pescanik”.⁸

Sipas informatave të tyre të konfirmuara, thuhet se në hetimin e Prokurorisë për Krime lufte në Beograd, është konfirmuar se të burgosurit me përkatësi serbe, dhe të dënuar për krime të rënda, janë transferuar nga burgjet e sigurisë maksimale të Beogradit, Nishit dhe Pozharevcit në burgun e Dubravës. Ky transferim kishte ndodhur me urdhër të ministrit të atëhershëm të drejtësisë Dragolub Janković. Po sipas këtij burimi (identik me dëshmitë e shumta të të mbijetuarve të masakrës së Dubravës), të burgosurit serbë në Dubravë, kanë gëzuar privilegje të veçanta. Ata ishin pajisë me radio pajisje “motorolla”, kanë pasur në dispozicion automjete zyrtare për lëvizje brenda dhe jashtë burgut, si dhe kanë qenë të armatosur me pushkë automatike, gjysmautomatike, revole, municion, raketahedhës “zola” dhe granata dore.

Të gjitha këto armë dhe pajisje (gjithnjë sipas dëshmive nga këto burime), pas kthimit të tyre në Serbi dhe përfundimit të misionit kriminal, i kanë dorëzuar me procesverbal tek autoritetet e burgut. Armatosja e të burgosurve serbë dhe përfshirja e tyre në masakrën e Dubravës, për herë të parë përmendet në një “Kallëzim penal për krime lufte dhe vjedhje të pagave tona” të një grupi serb, pjesëmarrës në luftë, të datës 29 korrik 2008. Ky lloj dokumenti si kallëzim penal i drejtohet Qeverisë së Serbisë, Prokurorisë serbe, Avokatit të Popullit, ministrit të Drejtësisë dhe drejtorit të burgut të Dubravës. Më 19 maj 1999, gjithçka po përfundonte, jo sipas pritjeve të autoriteteve serbe të burgut. Mbikëqyrësi i burgut (epror) Branko Komatina urdhëroi njërin nga të burgosurit serb, edhe ky i armatosur, të futej brenda dhe të verifikonte mundësinë për të mbyllur të burgosurit brenda nëpër pavijone, ashtu siç ishin më parë. Serbi i burgosur i hyri menjëherë verifikimit të gjendjes. U kthye në çast në punonjës burgu. Doli që andej dhe i tha Brankit, se qe e pamundur t’i mbyllnin të gjitha dyert dhe drynat. Ishin fort të dëmtuara për t’u riparuar shpejt. Mbikëqyrësi Komatina e shfaqti pakënaqësinë me tërë qenien e vet. Ashtu i nervozuar, që nuk po i shkonte realizimi i planit sipas planifikimit, urdhëroi që të burgosurit të futeshin brenda dhe të mos lëviznin nga dhomat. Gardianët e shoqëruar nga të burgosurit serbë, të armatosur, nuk rrinin gjithë kohën brenda burgut, ata largoheshin dhe dilnin jashtë mureve të burgut, posa fillonte të errësohej.

⁸ *Po aty.*

Nuk dihej arsyeja e saktë, por ishin dy mundësi. E para mund të ishte frika e tyre nga ndonjë goditje tjetër e avionëve të NATO-s. E dyta, ngase dyert e qelive dhe dhomave të burgut nuk ishin të mbyllura me kyçe e dryna.

Plani serb i kurdisur për masakrimin e të burgosurve shqiptarë po funksiononte. Sipas shënimeve dhe deklarimeve të vet zyrtarëve serbë, në burgun e Dubravës ishin grumbulluar diçka më shumë se 1 000 të burgosur shqiptarë. Të dënuar në proces të hetimeve, të kidnapuar e të mbledhur nga shtëpitë dhe lagjet gjithandej nëpër Kosovë, ishin banorët e atij kampi. Tani nuk kishte dyshim se Dubrava ishte shndërruar në kamp përqendrimi dhe grumbullimi në atë masë i njerëzve aty, kishte vetëm një qëllim. Vrasjen dhe zhdukjen e tyre!. Bombardimi i NATO-s mbi burgun ishte llogaritë paraprakisht nga autoritetet serbe, prandaj shqiptarët e grumbulluar aty shërbenin mish për top. (Për këtë rrezik të planifikuar të autoriteteve serbe, kishte shkruar një artikull *“Fears Mount for Albanian Prisoners”* edhe prestigjiozja *The Washington Post*⁹). Dhe vërtet, dita e 21 majit, ishte e tmerrshme. Gjithë ditën kishte goditje në objektet e burgut dhe në rrethinë. Ndonëse NATO kishte rënë në kurthin e serbëve, gjithsej kishte vra rreth 24 të burgosur dhe kishte plagosur me dhjetëra të tjerë. Edhe pse të burgosurit e mbledhur në mes oborrit të burgut shihnin me skepticizëm e kuptonin se NATO nuk kishte qëllim që t’i dëmtonte të burgosurit e pambrojtur. Për kurthin e ngritur dhe pasojat e këtij sulmi, si duket NATO e kuptoi vetëm një ditë, pas 22 majit. Mirëpo, ata që kishin planifikuar këtë masakër, e kishin menduar edhe këtë, prandaj në agimin e 22 majit, ata vunë në zbatim planin tjetër vrastar.

Ishte mëngjesi i 22 majit të vitit 1999. Zëri kumbues me nuanca paralajmëruese dhe urdhërues i një personi, që nuk i shihej fytyra, nga karakolli në pjesën perëndimore të burgut, po thoshte: *“Slusajte”*¹⁰! *“Për 15 minuta të bëheni gati, sepse tani nuk ka më kushte për t’ju mbajtur këtu dhe do t’ju transferojmë në një burg më të sigurtë. Për 15 minuta të rreshtoheni aty ku jeni”*, dhe tregonte me shenjë aty afër mureve nga këndi i karakollit. Ashtu siç ishin të burgosurit, të lodhur dhe të molisur nga dita e shkuar dhe nata nën qiell të hapur, filluan krejt me inercion të mblidhnin ato gjëra që kishin me vete dhe të ktheheshin sërish te fusha e sportit, sa më afër murit, që t’u mundësonin të “numëronin” nga karakolli. Pa kaluar mirë 15 minuta, të burgosurit shqiptarë ishin të gatshëm të merrnim udhën. Nga lodhja, as që

⁹ By Peter Finn and R. Jeffrey Smith Washington Post Foreign Service Wednesday, June 2, 1999; Page A20

<https://www.washingtonpost.com/wp-srv/inatl/longterm/balkans/stories/prisoners060399.htm>

¹⁰ Shprehje në gjuhën serbe, që në gjuhën shqipe do të thotë: dëgjoni.

po e vinin mendjen të mendonin për ndonjë kurth të përgatitur. Pa dashur, po ua lehtësonim punën duke formuar një resht të trashë, nga 4-5 veta, në vijë. Shto këtu që po i afroreshin gjithnjë e më shumë karakollit, me idenë, se nga aty do t'i numëronin dhe ndanin më lehtë.

Posa ishte rreshtuar ai rresht i madh i të burgosurve (rreth 950 veta, sepse disa tani veçse kishin vdekur dhe disa nuk ngriheshin nga plagët), ndodhi ajo që askush nuk e kishte pritur. Filluan të shtënat nga të gjitha drejtimet, nga karakolli dhe muri për bri karakollës. Fillimisht me bomba dhe granata dore, me pastaj me një arsenal të paparë armatimi, si: pushkë automatike, mitraloza e raketahedhës dore. Po ndodhte një skenë filmi horror. Forcat Serbe kishin hipur në karakoll, mbi muret përreth, mbi kamionët dhe traktorë dhe gjuanin me gjithë çka kishin! Gjuanin pa pushim! I hidhnin me lehtësinë me të cilat mund të hedhësh domatet e mollët. Por, ato nuk ishin as domate e as mollë!. Ishin bomba dhe granata dore të cilat vrisnin! Njerëzit binin nga goditjet dhe nuk ngriheshin më!

Pas valës së parë goditëse, çdokush vraponte instinktivisht. Për ata që nuk ishin goditë dhe po dilnin jashtë rrezes së veprimit të bombave dhe granatave të dorës, fillonte faza tjetër e operacionit. Tani filluan të gjuanin me mjetet tjera luftarake. Gjuanin me mortaja dore (zolla), mitraloza e pushkë të tjera automatike. Njerëzit iknin furishëm, por aty këtu i shihje tek binin më tej, nga predhat dhe plumbat e shkrepur. Pasi u larguan nga perimetri i vdekjes, nga muri dhe karakolli, prapë vdekja i ndiqte të burgosurit, sepse tani serbët shtinin nga distanca me pushkë snajper. Të gjendur para shumë rreziqeve, të burgosurit nisën të shihnim me shpresë bodrumin e kuzhinës. Disa të tjerë u strehuan në puseta të ndryshme: të nxehjeve, ujësjellësit e madje edhe të kanalizimeve dhe ujërave. Ishte krijuar ndjenjë e keqe e pasigurisë së plotë. Nga çdo kënd i ekspozoheshin goditjeve vdekjeprurëse. Në të tilla rrethana njeriu kurrë nuk mund ta di se cili veprim është më i duhuri. Thjesht vepron aty për aty, pastaj mendon se e ka zgjedhur gabim. Ndjenja e instinktit e shtyn vetëm të kërkojë ende. Futja në bodrume të ndërtesave dhe nëpër puseta sikur i shpëtoi për ca kohë. Mirëpo ende ishin para dy rreziqeve permanente. Njëri rrezik ishte ai i bombardimeve të NATO-s. Tjetri ishin vrasësit serbë që kishin nisur që nga mëngjesi pushkatim masiv. Dikush hodhi një ide të shkëlqyer për të eliminuar të paktën rrezikun nga bombardimet. Ishte i riu nga grupi i Gjakovës, Yll Ferizi dhe Avni Kolgeci nga Theranda. Këta të dy, së bashku me 3-4 të tjerë, nisën të mbledhin plastika të bardha të dimensioneve 20-25 centimetra gjerësi dhe mbi me 1 metër gjatësi. Të tilla kishte kudo nëpër pavijone. U shërbenin dritave të neonit si kornizë mbrojtëse. Ashtu shpejt e shpejt, para hapësirës së kuzhinës dhe pavijoneve të tjera, pra në pjesën qendrore të burgut, shkruan fjalën “HELP”. Shpresonin të paralajmëronin

avionët e NATO-s, që, në mos tjetër, të mos bombardonin më mbi burgun. Kjo ide brilante në atë kaos pasigurie, jo vetëm që ishte e qëlluar, por pati edhe efektin pozitiv. Me që ishte ditë e kthjellët me diell, shkronjat e realizuara nga Ylli, Avniu dhe djemtë e tjerë, mund të dalloheshin fare lehtë. Mesazhi, si duket, kishte shkuar ku duhej. Nga ai moment nuk pati bombardime të NATO-s. Bombardimet u ndalën, por u tërbuan serbët militarë dhe paramilitarë të cilët mbanin të rrethuar burgun. Ata posa i vërejtën shkronjat “HELP” në mes të oborrit prej karakollit mbi fushën e sportit, duke ditur mesazhin që morën avionët mbi qiellin e hapur, shumë shpejt u mobilizuan. U futën brenda me një arsenal armësh.

Të maskuar dhe të mbrojtur me pancir, filluan me gjuajtje dhe ekzekutime të rrufeshme ku mundnin. Bishat e tërbuara me atë vrull vrastar, fillimisht shkuan tek vendi ku ishte shkruar fjala “HELP”. Mbaruan punën me shënimin. Më kot bërtisnin e çirreshin për të marrë vesh se cili qe autori. Askush nuk i afrohej vdekjes. Të gjithë kërkonin ta shtynin vdekjen, qoftë edhe për një çast. Filluan të gjuanin përsëri, aty ku ndjenin ndonjë lëvizje njeriu. Pastaj u drejtuan nga pusetat. Pengjet kishin llogaritur më shumë mbrojtjen prej bombardimeve e prej të shtënave nga larg. Por jo, prej një sulmi të tillë. Serbët i kishin vëzhguar dhe identifikuar nga larg vendet ku ishin strehuar disa të burgosur-pengje. Me gjakftohtësinë e vrasësit serik, afroheshin dhe hidhnin bomba dore e granata në puseta. Aty mbetën shumë të vrarë e të plagosur.

Dëmi i granatave, ishte më i vogël, ku një numër i madh i të burgosurve ishin strehuar në ngushtësinë e pusetës. Ama në disa puseta kishte ndodhur mrekullia. Ngaqë ishin hedh dy-tri granata, kishin vdekur vetëm dy-tre veta, dhe kishin shpëtuar të tjerët. Dy-tre trupat e vdekur ishin bërë “kurban” dhe mburojë për të tjerët. Ciflat e granatave kishin copëtuar vetëm trupat e atyre fatkeqëve që ishin gjendur në mes apo në skajet e pusetave, aty ku kishin rënë granatat. Vrasësit vazhduan aksionin e tyre. Nisën madje të gjuanin edhe nga distanca. Por edhe municioni i tyre e kishte një fund. Pasi shkatërruan shkrimin “HELP” dhe vranë sa mundën të burgosur, më në fund morën rrugën nga kishin ardhur. Dolën nga ajo deriçka e vogël, që lidhte hapësirat e burgut me objektin e kujdestarisë dhe drejtorisë së burgut. Ajo deriçkë, në kushte normale, shërbente për vizitat e ndryshme të udhëheqësve të burgut, ministrive apo edhe organizatave humanitare të të drejtave të njeriut. Kësaj here, bilanci i vizitës “VIP” ishte i kobshëm. Me dhjetëra të burgosur u ekzekutuan, shumë e shumë të tjerë u plagosën varësisht pozicionit dhe fatit. Sido që të jetë, fatkeqësia po i përcillte të burgosurit e pambrojtur si këmisha e trupit. Dalja e asaj ekspedite vrastare prej asaj deriçke të vizitave “VIP”, nuk ishte se e mbylli misionin e tyre vrasës. Ishte vetëm pushimi fizik dhe furnizimi logjistik me

municione. Nga mënyra se si ngarendnin në ato ekzekutime, të krijohej lehtë përshtypja, se ata po bënin gara kush po vret më shumë.

Dita më e kobshme ishte ajo e 22 majit! Këtë ditë u vranë dhe masakruan shumë të burgosur. Fillimisht në rreshtin tinëzar të vdekjes, në puseta, në bodrum e ku jo!? Ekzekutimet vazhduan gjithë ditën, për të vazhduar edhe të nesërmen, më 23 maj 1999. Numri i saktë i atyre që mbeten të varë në burgun e Dubravës, ende, edhe sot e kësaj dite nuk është i saktë. Ende ka njerëz që gjinden në listat e të zhdukurve. Përveç 97 trupave të pajetë të të burgosurve, të cilët u gjeten në varrezat e Rakoshit, ka të dhëna se një pjesë e kufomave të paidentifikuara janë bartë dhe janë varrosë në një varr masiv afër malit Mokra Gora, nja 20 kilometra larg Dubravës. Rasti i zhdukjes pa gjurmë i profesorit Ukshin Hoti, edhe sot e kësaj dite mbetet i pazbardhur. Profesori Ukshin Hoti u nxor nga burgu i Dubravës, më 16 maj 1999, një ditë para se t'i mbaronte dënimi. Se ishte nxjerr me qëllim dhe me një plan morbid, nuk do mend, pasi në praktikat e burgjeve nuk ekziston asnjë rast kur të burgosurit lirohen ditën e diel, ngaqë llogaritet ditë vikendi dhe nuk punon administrata. Sipas praktikave, nëse të burgosurit i skadon dënimi ditëve të vikendit, ai lirohet një ditë më herët. Ndërsa, te profesor Ukshin Hoti, ndodhi e kundërta. Nga plagët e marra në burgun e Dubravës kanë vdekur edhe një numër i të burgosurve në burgjet tjera, në Lipjan, dhe pas 10 qershorit 1999, edhe në burgjet e Serbisë.

Burgjet e aplikuara ndaj të burgosurve shqiptarë (sidomos ndaj të burgosurve politikë), në periudha të ndryshme kohore, ishin pjesë e strategjisë dhe projektit serbomadh gjenocidial ndaj shqiptarëve. Fakti se shqiptarët nën Jugosllavi-Serbi ishin populli me numrin më të madh të të burgosurve krahasuar me numrin e banorëve, tregon për pozitën gjendjen e tyre shoqërore dhe politike. Trajtimi i shqiptarëve në burgje ishte refleksion i trajtimit kolektiv që Serbia u bënte shqiptarëve në Jugosllavi-Serbi. Burgje zyrtare dallonin nga njeri-tjetri vetëm me faktin se shqiptarët u nënshtroheshin disa procedurave hetimore dhe gjyqësore, ndërsa padrejtësitë dhe terrori shtrihej gjithandej ku kishte shqiptarë duke e shndërruar Kosovën dhe viset tjera shqiptare në burgun më të madh kolektiv në Evropë e më gjerë. Torturat, fyerjet, denigrimi e deri te vrasjet pa gjyq, ishin metoda që Serbia aplikonte ndaj shqiptarëve me të vetmen arsyeje se nuk ishin sllavë. Kulminacioni i metodave gjenocidiale të zbatuara ndaj të burgosurve shqiptarë, arrin në maj të vitit 1999 kur forcat serbe kryejnë një krim monstruoz ndaj të burgosurve shqiptarë. Të gjitha faktet dhe dëshmitë e dëshmitarëve vërtetojnë tezen se qëllimi i vetëm i grumbullimit të të burgosurve shqiptarë në atë kohë dhe në atë vend, kishte për qëllim vrasjen e tyre. Dëshmitë e shumta vërtetojnë se ka ekzistuar një plan i përpunuar mirë nga hierarkia politike dhe ushtarake e Serbisë.

Armatosja e të burgosurve ordinerë serbë dhe transferimi i tyre nga burgjet e Serbisë qendrore në Dubravë, përshfaq edhe një element tjetër të dinakërisë, duke tentuar të kamuflonte këtë masakër. I gjithë skenari i asaj masakre dhe zbatimi i atij plani ka emër dhe mbiemër. Është masakra dhe krimi gjenocidal më i madhi dhe më i pashembullt në fundshekullin XX. Për këtë masakër ndaj të burgosurve të pambrojtur shqiptarë, ekzistojnë elemente të mjaftueshme që e barazojnë me kampet e përqendrimit të Luftës së Dytë Botërore të zbatuara ndaj hebrenjve. Mjafton të përmendim faktin se në atë kamp (burgun e Dubravës), ishin grumbulluar të burgosur politikë, të burgosur ordinerë, të paraburgosur e madje edhe qytetarë pa asnjë procedurë. Motoja kryesore e grumbullimit të tyre, në numër aq të madh kishte të bënte me zbatimin e planit fashist serb për vrasjen dhe likuidimin e sa më shumë shqiptarëve, pa dallim.

Indiferenca e madhe ndërkombëtare dhe vendore kundrejt zbardhjes së kësaj masakre, është një zhgënjim i madh. Menjëherë pas mbarimit të luftës, administrata e UNMIK-ut merr vendim që të rinovon (adapton) këtë burg duke mbuluar dhe zhdrukë pothuajse të gjitha gjurmët e masakrës më të tmerrshme të luftës. Ky vendim mjaft i dëmshëm dhe i dyshimtë kaloi shumë lehtë dhe i padiktueshëm edhe nga vendorët. Tani i gjithë ai tmerr, ekziston dhe sillet në memoret e të mbijetuarve të cilët në pamundësi të ndryshimit të kësaj gjendje, mundohen të sjellin kujtimet e tyre për ndërgjegjen e vrarë kolektive.